



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 5

31 janar

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr. 7930 datë 22.1.2013	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare 117
Dekret nr. 7938 datë 25.1.2013	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 117
Vendim i Kuvendit nr.1/2013, datë 21.1.2013	Për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive..... 118
Vendim i KM nr. 13, datë 4.1.2013	Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis.. 118
Udhëzim i MF nr. 3, datë 22.1.2013	Për disa shtesa në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar..... 131
Udhëzim i MF nr. 4, datë 22.1.2013	Për disa shtesa në udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar 132
Urdhër i MPPT nr. 2, datë 14.1.2013	Për delegim kompetencash..... 134
Urdhër i MBUMK nr. 13 datë 15.1.2013	Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së “Kontratës tip” për dhënien me qira të tokave bujqësore, të pandara..... 134

DEKRET

Nr. 7930, datë 22.1.2013

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|-----------------------------------|-----------------------------------|
| 1. Anduena Alfred Kushi | 11. Laora Basri Çullhaj (Buzhiqi) |
| 2. Alban Veiz Gjoni | 12. Isola Shpëtim Geef (Pobrat) |
| 3. Evis Eqerem Boge (Bundo) | 13. Eni Ilir Miluka |
| 4. Henson Muharrem Nguci | 14. Ermir Xhevdet Pulaha |
| 5. Vladimir Petrit Shabani | 15. Artenor Enver Stutz (Idrizi) |
| 6. Fatos Sadik Plaku | 16. Elton Avdyl Duka |
| 7. Samuel Fatos Plaku | 17. Alfred Safet Mane |
| 8. Evelina Muhamet Plaku (Dushku) | 18. Ilir Zazan Dollaku |
| 9. Titi Fatos Plaku | 19. Taulant Napolon Skënderi |
| 10. Dalip Enver Keçi | 20. Denis Theodhor Papa |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 7938, datë 25.1.2013

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe 93, të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij personit të mëposhtëm:

Endrit Reshit Krasniqi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani



VENDIM
Nr. 1/2013

**PËR ZGJEDHJEN E INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM TË INSPEKTORATIT TË LARTË
TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE**

Në mbështetje të nenit 11 pika 2 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Zana Xhuka zgjidhet në detyrën e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miraturar në datën 21.1.2013

VENDIM
Nr. 13, datë 4.1.2013

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE, TË PËRGJEGJËSIVE E TË AFATEVE PËR
ZHVILLIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 7 të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- I. Miratimin e rregullave, të përgjegjësisve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) të projekteve të caktuara private apo publike, si më poshtë vijon:

KREU I
ZHVILLIMI I PROCEDURËS PARAPRAKE TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

A. Fazat e procedurës paraprake të VNM-së

Procedura paraprake e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VND) zbatohet për projektet që janë subjekt i kërkesave të nenit 8 të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, dhe kalon në këto faza të njëpasnjëshme:

¹ Projekt vendimi synon të bëjë përafrimin e plotë të direktivës nr. 92/2011/EEC “Për vlerësimin e efekteve që shkaktohen në mjedis nga aktivitetet private dhe publike”, e kodifikuar në 2012 (Celex: 32011L0092:OJ L026,28.01.2012, p.0001-0021).

a) Paraqitja e kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues nga zhvilluesi në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe përcjellja e tyre nga QKL-ja në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM);

b) Konsultimi i AKM-së me institucionet e tjera dhe publikimi i kërkesës;

c) Marrja e vendimit nga AKM-ja, njoftimi i QKL-së, Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, institucioneve të konsultuara, si dhe publikimi i vendimit në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave.

B. Paraqitja e kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues nga ana e zhvilluesit në QKL dhe përcjellja e dokumentacionit në AKM

1. Zhvilluesi, që synon të zbatojë një projekt, i cili është subjekt i kërkesave të nenit 8 të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, që në fazat fillestare të planifikimit të projektit (projektidesë), paraqet pranë QKL-së, përveç dokumentacionit të kërkuar sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, dhe dokumentacionin përkatës, i cili përmban:

1.1. Përshkrimin e projektit të propozuar, ku përfshihen:

a) përshkrimi i qëllimit të projektit të propozuar;

b) planimetria e vendndodhjes së projektit ku të pasqyrohen në hartë topografike sipërfaqja e tokës së kërkuar, kufijtë e sipërfaqes së tokës së kërkuar, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë së projektit;

c) informacioni për qendrat e banuara në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën nga vendi ku propozohet projekti e për njësinë e qeverisjes vendore (bashkia/komuna) që administron territorin ku propozohet projekti;

ç) skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit;

d) përshkrimi i proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;

dh) informacioni për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;

e) programi për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit;

ë) mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit;

f) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);

g) informacioni për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;

gj) informacioni për alternativat e marra në konsideratë për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;

h) të dhëna për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të ujit të nevojshëm, energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;

i) aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si: ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;

j) informacioni për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/licencimin e projektit.

1.2 Raportin paraprak të VNM-së, ku përfshihen:

a) një përshkrim i shkurtër i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me imazhe;

b) informacioni për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj;



c) një identifikim i ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;

ç) një përshkrim i shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;

d) informacioni për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar;

dh) të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësimore të ndikimit negativ në mjedis që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;

e) mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, përfshi edhe kthimin e tokës bujqësore (në rast se përdorimi ekzistues është i tillë) dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;

ë) masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;

f) ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë);

g) certifikatën dhe licencën përkatëse të QKL-së, të specialistit që ka hartuar raportin paraprak të VNM-së.

1.3 Faturën e pagesës së tarifës së shërbimit

2. QKL-ja, brenda 4 (katër) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues nga zhvilluesi, e përcjell në AKM për të vlerësuar dhe vendosur nëse projekti i propozuar për shkak të ndikimeve të rëndësishme negative në mjedis, që mund të ketë, duhet t'i nënshtrohet apo jo procedurës së thelluar të VNM-së.

3. Nëse informacioni i paraqitur nga zhvilluesi, nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 1 të ndarjes "B" të këtij kreu, atëherë AKM-ja, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", komunikon me QKL-në dhe kërkon plotësimin e informacionit që mungon duke dhënë edhe arsyetimin përkatës.

C. Konsultimi i AKM-së me institucione të tjera dhe publikimi i kërkesës

1. AKM-ja, në zbatim të nenit 15 të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së (aplikimit) dokumentacionit prej QKL-së, u dërgon për mendim/konsultim një kopje të plotë të tij institucioneve të mëposhtme, duke u theksuar edhe afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh për dërgimin e mendimit të tyre:

a) Ministrive të linjës, të cilat kanë përgjegjësi në planifikimin e territorit, mbrojtjen e shëndetit publik, tokës bujqësore, zhvillimit të ekonomisë, si dhe zhvillimin e infrastrukturës publike;

b) Institucioneve të tjera që në varësi të llojit të projektit janë përgjegjëse për lejimin/licencimin e tij apo përgjegjëse për emergjencat natyrore dhe civile;

c) Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM) në qarkun ku propozohet të zbatohet projekti, së cilës i jepen edhe udhëzimet përkatëse për marrjen e mendimit nga institucionet e qeverisjes në qark.

2. ARM-ja, brenda 3 (tri) ditëve nga data e marrjes së dokumentacionit nga AKM-ja, u dërgon një kopje të tij institucioneve përfaqësuese të qeverisjes qendrore në qark me përgjegjësi sipas shkronjave "a" dhe "b" të pikës 1 të ndarjes "C", si dhe njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti, duke u përcaktuar edhe afatin prej 12 (dymbëdhjetë) ditësh për dhënien e mendimit nga secili institucion.

3. ARM-ja dërgon në AKM mendimet dhe informacionin përkatës brenda 3 (tri) ditëve nga afati i mbarimit të dhënies së mendimit nga institucionet e konsultuara prej saj.

4. Institucionet e përmendura në pikat 1 dhe 2 të ndarjes "C", japin mendimin për projektin e propozuar brenda afatit të përcaktuar dhe nëse nuk i paraqesin ato brenda këtij afati nënkuptohet se ato janë dakord me zhvillimin e projektit dhe nuk kanë komente.

5. Me qëllim informimin e publikut dhe OFJ-ve, AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së aplikimit prej QKL-së publikon në faqen e saj në internet për 20 (njëzet) ditë rresht informacionin e paraqitur nga zhvilluesi, duke sqaruar procedurën që po zbatohet, si dhe afatin e parashikuar të publikimit të vendimit të saj në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave.

Ç. Marrja e vendimit nga AKM-ja, njoftimi i QKL-së, ministrisë, institucioneve të konsultuara dhe publikimi i vendimit

1. AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e përfundimit të afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 3 të ndarjes “C”, merr vendim duke u mbështetur në kriteret ndihmëse të trajtuara në shtojcën I, në përputhje me përcaktimet e nenit 11 të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

2. Vendimi i AKM-së u njoftohet menjëherë QKL-së, ministrisë dhe institucioneve të konsultuara, ndërsa një kopje e tij publikohet menjëherë në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave.

3. Ndaj vendimit mund të bëhet ankim në QKL, në përputhje me përcaktimet e nenit 30 të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 25 të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

KREU II ZHVILLIMI I PROCEDURËS SË THELLUAR TË VNM-SË

A. Fazat e zhvillimit të procedurës së thelluar të VNM-së

Procedura e thelluar e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) zbatohet për projektet që janë subjekt i kërkesave të nenit 9 të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, dhe ndjek këto faza të njëpasnjëshme:

- a) njoftimin e AKM-së nga zhvilluesi për synimin e zhvillimit të projektit;
- b) konsultimin e AKM-së me institucionet e tjera, publikun dhe OJF-të për çështjet që ato kërkojnë të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së;
- c) komunikimin që AKM-ja i bën zhvilluesit për çështjet që ajo dhe palët e konsultuara kërkojnë të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së;
- ç) hartimin e raportit të thelluar të VNM-së dhe dëgjuesën me publikun;
- d) aplikimin në QKL për deklaratën mjedisore, shqyrtimin nga AKM-ja dhe lëshimin e saj nga ministri.

B. Njoftimi i AKM-së nga zhvilluesi

1. Zhvilluesi, që synon të zbatojë një projekt, që është subjekt i procedurës së thelluar të VNM-së, njofton AKM-në që në fazat fillestare të zhvillimit të projektit (projektidesë), duke e shoqëruar me informacionin e poshtëshënuar e, konkretisht, me të dhëna për projektin e propozuar, ku, në varësi nga lloji i projektit, përfshihen:

1.1 Përshkrimi i projektit të propozuar, që përmban:

- a) përshkrimin e qëllimit të projektit të propozuar;
- b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike sipërfaqja e tokës së kërkuar, kufijtë e sipërfaqes së tokës së kërkuar, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës, që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë së projektit;
- c) informacion për qendrat e banuara në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe me të dhëna për distancën nga vendi ku propozohet projekti e për njësinë e qeverisjes vendore (bashkia/komuna), që administron territorin ku propozohet projekti;
- ç) skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit;
- d) përshkrim të proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;
- dh) të dhëna për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;

e) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit;

ë) mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit;



f) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyrën e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);

g) informacion për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;

gj) informacion për alternativat e marra në konsideratë për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;

h) të dhëna për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasinë e ujit të nevojshëm, energjisë, lëndëve djegëse dhe për mënyrën e sigurimit të tyre;

i) të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;

j) informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/licencimin e projektit.

1.2 Informacion për ndërveprimin me mjedisin të projektit (si shtojcë të pikës 1.1 më sipër), që përmban:

a) një përshkrim të shkurtër të mbulesës bimore të sipërfaqes, ku propozohet të zbatohet projekti, të shoqëruar dhe me imazhe;

b) informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj;

c) një identifikim të ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë, ajër;

ç) një përshkrim të shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, si dhe prodhimin e mbetjeve;

d) informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;

dh) të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;

e) mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, përfshi edhe tokën bujqësore, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;

ë) masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;

f) ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

1.3. Faturën e pagesës së tarifës së shërbimit sipas përcaktimeve në legjislacion.

2. Në rast se informacioni i paraqitur nga zhvilluesi, nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 2 të ndarjes “B” të kreut II të këtij vendimi, atëherë AKM-ja komunikon me zhvilluesin dhe i kërkon atij plotësimin e informacionit të munguar.

3. Afatet për plotësimin e informacionit të munguar nga zhvilluesi, nuk llogariten për efekt të afateve kohore të procedurës së thelluar të VNM-së.

C. Konsultimi i AKM-së me institucionet e tjera, publikun dhe OJF-të për çështjet që ato kërkojnë të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së

1. AKM-ja, në zbatim të nenit 14 të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së (aplikimit) dokumentacionit prej QKL-së, u dërgon për mendim/konsultim një kopje të plotë të tij institucioneve të mëposhtme, duke u theksuar edhe afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh për dërgimin e mendimit të tyre:

a) Ministrive të linjës, të cilat kanë përgjegjësi në planifikimin e territorit, mbrojtjen e shëndetit publik, tokës bujqësore, zhvillimit të ekonomisë, si dhe zhvillimin e infrastrukturës publike;

b) Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM) në qarkun ku propozohet të zbatohet projekti, së cilës i jepen edhe udhëzimet përkatëse për marrjen e mendimit nga institucionet e qeverisjes në qark;

c) Institucioneve të tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin/licencimin e tij apo përgjegjëse për emergjencat natyrore dhe civile.

2. ARM-ja, brenda 3 (tri) ditëve nga data e marrjes së dokumentacionit nga AKM-ja, u dërgon një kopje të tij institucioneve përfaqësuese të qeverisjes qendrore në qark me përgjegjësi sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1 të kësaj ndarjeje, si dhe njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku

propozohet projekti, duke u përcaktuar edhe afatin prej 12 (dymbëdhjetë) ditësh për dhënien e mendimit nga secili institucion.

3. ARM-ja dërgon në AKM mendimet dhe informacionin përkatës brenda 3 (tri) ditëve nga afati i mbarimit të dhënies së mendimit nga institucionet e konsultuara prej saj.

4. Për të bërë të mundur informimin dhe marrjen e mendimit nga publiku dhe OJF-të, AKM-ja publikon në faqen e saj elektronike, për 20 (njëzet) ditë rresht, informacionin e paraqitur nga subjekti, duke sqaruar se brenda këtij afati mund të jepen mendime për çështjet që duan të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së, si dhe sqarimet për procedurën që do të zbatohet për informimin e konsultimin dhe dëgjuesën publike.

5. Institucionet e përmendura në pikat 1 dhe 2 të kësaj ndarjeje, publiku dhe OJF-të japin mendimin e tyre brenda afatit të kërkuar më sipër dhe nëse ato nuk e paraqesin brenda afatit, nënkuptohet se nuk kanë kërkesa apo sugjerime për çështjet që do të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së.

Ç. Komunikimi që AKM-ja i bën zhvilluesit për çështjet që ajo dhe palët e konsultuara kërkojnë të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së

1. Brenda 5 (pesë) ditëve nga data e përfundimit të afatit për marrjen e mendimit, sipas përcaktimit të ndarjes “C” të këtij kreu, AKM-ja i komunikon me shkrim zhvilluesit, si më poshtë vijon:

a) Kërkesat e saj, të institucioneve, publikut dhe të OJF-ve, të cilat duhet të merren parasysh dhe të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së;

b) Një sqarim të përmbledhur për kërkesat e procedurës së thelluar të VNM-së, deri në paraqitjen e aplikimit në QKL dhe dhënien e deklaratës mjedisore;

c) Detyrimin për informimin, konsultimin dhe dëgjuesën me publikun dhe OJF-të të raportit të thelluar të VNM-së dhe vlerësimin e mendimeve të dhëna në raport përpara se të paraqitet në QKL;

ç) Analizimin e të paktën dy alternativave për zbatimin e projektit;

d) Udhëzime për studimet dhe metodat për sigurimin e informacionit mjedisor dhe parashikimin e ndikimeve në mjedis gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së;

dh) Udhëzime për masat për mbrojtjen e mjedisit që duhet të merren në konsideratë gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së;

e) Strukturën dhe renditjen e informacionit në raportin e thelluar të VNM-së, në përputhje me shtojcën II të këtij vendimi;

ë) Faktin që projekti është subjekt i procedurës ndërkufitare të VNM-së, duke dhënë edhe udhëzimet përkatëse për këtë rast.

2. Komunikimi i AKM-së me zhvilluesin publikohet, menjëherë në faqen elektronike të AKM-së dhe një kopje u dërgohet institucioneve të konsultuara.

3. Nëse AKM-ja nuk i komunikon zhvilluesit brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të kësaj ndarjeje, atëherë zhvilluesi vijon me hartimin e raportit në përputhje me përcaktimet e shtojcës II të këtij vendimi.

D. Hartimi i raportit të thelluar të VNM-së dhe dëgjesa publike

1. Hartimi i raportit të thelluar të VNM-së është përgjegjësi e zhvilluesit dhe hartohet në përputhje me shtojcën II të këtij vendimi. Gjatë hartimit të tij, zhvilluesi informon dhe konsultohet me publikun në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

2. Pasi është hartuar raporti i thelluar i VNM-së, zhvilluesi njofton AKM-në për organizimin e dëgjuesës publike, duke e informuar edhe për informimin dhe konsultimet e kryera gjatë hartimit të raportit.

3. AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, i kërkon Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM) të bashkëpunojë me njësinë e qeverisjes vendore dhe me zhvilluesin e projektit për realizimin e dëgjuesës publike në përputhje me kërkesat e nenit 17 të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, dhe të akteve ligjore përkatëse.

4. ARM-ja është e pranishme në ditën e dëgjuesës publike dhe ka rol mbikëqyrës, duke regjistruar në mënyrë të pavarur mendimet dhe kërkesat e dhëna gjatë takimit nga publiku dhe palët e pranishme.



5. ARM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i seancës dëgjimore, përcjell në AKM informacion për mënyrën se si është zbatuar procedura, si dhe mendimet e kërkesat e dhëna nga publiku dhe palët e pranishme.

KREU III

PARAQITJA NË QENDRËN KOMBËTARE TË LICENCIMIT DHE DEKLARATA MJEDISORE

A. Aplikimi në QKL

1. Në zbatim të nenit 10 të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, zhvilluesi, pasi të ketë hartuar raportin e thelluar të VNM-së dhe pasi të jetë kryer seanca dëgjimore për të, paraqet pranë QKL-së, përveç dokumentacionit të kërkuar sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, edhe këto dokumente:

- a) raportin e thelluar të VNM-së, i cili duhet të jetë në përputhje me kërkesat e shtojcës II;
- b) përmbledhjen joteknike të raportit të VNM-së;
- c) projektin teknik;
- ç) të dhëna për informimin dhe konsultimin me publikun dhe palët e tjera, realizuar gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së;
- d) një kopje të faturës së pagesës së tarifës së shërbimit sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës.

2. QKL-ja, brenda 4 (katër) ditëve, përcjell dokumentacionin e paraqitur pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), për të shqyrtuar për dhënien e deklaratës mjedisore për projektin.

B. Shqyrtimi dhe dhënia e deklaratës mjedisore

1. Brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së aplikimit prej QKL-së, AKM-ja publikon në faqen e saj elektronike për 20 (njëzet) ditë rresht, përmbledhjen joteknike të raportit të thelluar të VNM-së, duke sqaruar se brenda këtij afati publiku, OJF-të apo palët e tjera të interesuara mund të japin mendime përpara lëshimit të deklaratës mjedisore për ndikimet në mjedis të projektit.

2. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e përcjelljes së aplikimit prej QKL-së, AKM-ja shqyrton dokumentacionin dhe ministri lëshon deklaratën mjedisore, e cila hartohet në përputhje me përcaktimet në nenin 12 të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

3. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit për lëshimin e deklaratës mjedisore, AKM-ja bazohet në kriteret e shtojcës III të këtij vendimi.

4. Deklarata mjedisore u dërgohet menjëherë QKL-së, institucioneve të konsultuara, ndërsa një kopje publikohet menjëherë në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave.

5. Nëse informacioni i paraqitur nga zhvilluesi ka mangësi, atëherë AKM-ja, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, komunikon me QKL-në dhe kërkon plotësimin e informacionit që mungon, duke dhënë edhe arsyetimin ligjor dhe teknik për këtë kërkesë.

KREU IV

MONITORIMI I NDIKIMEVE, KONFIDENCIALITETI, ANKIMIMI DHE KOMUNIKIMI

1. Gjatë zbatimit të projektit, zhvilluesi ka përgjegjësinë të kryejë monitorimin e ndikimeve në mjedis të projektit, në përputhje me përcaktimet në deklaratën mjedisore dhe legjislacionin në fuqi.

2. Në rast se zhvilluesi gjykon se të dhëna të caktuara në dokumentacionin e kërkuar nga procedura e VNM-së janë konfidenciale, atëherë ai ua komunikon atë AKM-së dhe QKL-së që në momentin e paraqitjes së dokumentacionit ku përmbahen të dhënat konfidenciale.

3. Në rast se AKM-ja dhe QKL-ja njoftohen paraprakisht nga zhvilluesi për ruajtjen e të dhënave konfidenciale, atëherë ato zbatojnë kërkesat e legjislacionit përkatës sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për shoqëritë tregtare”, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ligjit nr. 9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të”, si dhe të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”.

4. Afatet kohore për llogari të procedurës së ruajtjes dhe administrimit të të dhënave konfidenciale nuk llogariten (i shtohen) në afatet e zbatimit të procedurës së VNM-së sipas këtij vendimi.

5. Çdo palë ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative, me kërkesë në QKL, ndaj akteve, veprimeve apo mosveprimeve gjatë zhvillimit të procedurës së VNM-së, në përputhje me kërkesat e nenit 25 të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, dhe sipas kërkesave të nenit 30 të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

6. Për përmbushjen e afateve kohore të kësaj procedure, institucionet me rol e përgjegjësi në këtë procedurë, sa të jetë e mundur, shkëmbejnë informacionin për projektin nëpërmjet komunikimit elektronik, në përputhje me përcaktimet në legjislacionin përkatës në fuqi.

II. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Qendra Kombëtare e Licencimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA I - Kriteret ndihmëse për marrjen e vendimit gjatë procedurës paraprake të VNM

1. Karakteristikat e projektit

- *madhësia e projektit;*
- *efektet kumulative me projekte të tjera;*
- *përdorimi i burimeve natyrore;*
- *prodhimi i mbetjeve,*
- *volumi i shkarikimit të ndotjes dhe zhurmes në mjedis;*
- *mundësia e aksidenteve me pasoja në mjedis , duke pasur parasysh në veçanti substancat apo teknologjitë e përdorura.*

2. Karakteristikat e mjedisit në zonen e projektit:

- a. përdorimi ekzistues i tokës se kerkuar nga projekti;
- b. gjendja e mjedisit në zonen ku propozohet projekti duke i kushtuar vëmendje të veçantë;



- ligatinave;
- zonave bregdetare;
- zonave pyjore;
- zonave të mbrojtura natyrore me rëndësi kombëtare dhe nderkombëtare dhe distancë e tyre nga zona ku propozohet projekti;
- biodiversitetit të zonës dhe statusit të ruajtjes/mbrojtjes;
- zonat ku janë tejkaluar standardet e cilësisë së mjedisit (të përcaktuara në akte të tjera);
- zonat me densitet të lartë të popullsisë;
- egzistencës së infrastrukturës mjedisore dhe aksesin e projektit në vëndet e depozitimit të mbetjeve dhe impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura;
- objekte me rëndësi historike, kulturore ose arkeologjike.

3. Karakteristikat e ndikimit të mundshëm në mjedis

Ndikimet e mundshme në mjedis të projektit të propozuar duhet të shqyrtohen në kombinim me kriteret e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 më lart, dhe duke marrë parasysh në menyre të veçante:

- *Llojin e ndikimeve të mundshme negative në mjedis;*
- *shtrirjen hapësinore të ndikimeve të mundshme negative në mjedis dhe kohezgjatjen e mundshme të tyre (zonën gjeografikë dhe madhësinë e popullsisë së prekur),*
- *shkallën dhe kompleksitetin e ndikimit,*
- *mundësinë e shfaqjes së ndikimeve,*
- *natyrën ndërkufitare të projektit dhe ndikimit në mjedisin ndërkufitar,*

Mendimet e kërkesat e dhëna nga institucionet sipas kreut I duke i përqendruar në:

- Ekzistencën dhe planet e përdorimit të tokës dhe zhvillimit në zonën e projektit;
- Përputhja e projektit me planet vendore, rajonale dhe kombëtare të zhvillimit;
- Kërkesa të veçanta për mbrojtjen e shëndetit publik nga ndikimet në mjedis të projektit.

SHTOJCA II – Struktura e renditjes dhe informacionit që përmban raporti i thelluar i VNM
Hyrje

Shpjegimi i akronimeve

1. Informacion për qëllimin e VNM dhe metodikën e zbatuar

- a) Përshkrim të qëllimit dhe objektivave të VNM;
- b) Përshkrim të përmbledhur të kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin;
- c) Përshkrim të metodikës të zbatuar për hartimin e raportit të thelluar të VNM-se;

- *Autorët e hartimit raportit të thelluar të VNM-së*
- *Metodikat e zbatuara dhe mënyra e sigurimit të informacionit për hartimit e raportit të thelluar të VNM-së (nëse është e detajuar mund të vihet edhe si shtojcë e raportit);*
- *Konsultimet e realizuara gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së;*
- *Një përshkrim të vështirësive (mangësive teknike ose të njohurive) që zhvilluesi ka hasur gjatë hartimit të informacionit të kërkuar.*

2. Përshkrimi i projektit, duke përfshirë:

- a. *Përshkrimin e qëllimit të projektit të propozuar;*
- b. *Planimetria e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike sipërfaqja e tokës së kërkuar, kufijtë e sipërfaqes së tokës së kërkuar, të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti gjatë fazës së ndërtimit apo instalimit të pajisjeve;*
- c. *Skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit;*
- d. *Përshkrim i proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;*
- e. *Infrastruktura e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;*
- f. *Programi për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe sipas rastit edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit;*
- g. *Mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit;*
- h. *Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);*
- i. *Informacion për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës të projektit;*
- j. *Informacion lidhur me alternativat e marra në konsideratë përse i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;*
- k. *Përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasitë e ujit të nevojshëm, energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyren e sigurimit të tyre;*
- l. *Aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj;*
- m. *Informacion për lejet dhe licensat e nevojshme për projektin të kërkuara nga legjislacioni në fuqi si dhe institucionet kompetente për lejimin/licensimin e projektit;*



3. Një përshkrim i analizës të paktën dy alternativave për zbatimin e projektit ose komponenteve të vecanta të tij (si aksesit rrugor, administrimi i mbetjeve dhe ujërave të ndotura, llojet e lendeve djegëse, vëndodhja e projektit etj) si dhe sqarimi i arsyeve kryesore për alternativën e propozuar, duke marrë parasysh ndikimet në mjedis të secilës alternative;
4. Një përshkrim të gjëndjes dhe vlerave egzistuese të mjedisit që mund të ndikohen nga zbatimi i projekti i propozuar, duke përfshirë;

4.1 Përshkrim të karakteristikave fizike të zonës së projektit;

- Përshkrim i faktorëve klimatikë;
- Përshkrimi gjeomorfologjik dhe i sizmitetit i zonës së projektit;
- Përshkrim i gjeologjisë dhe tokës në zonën e projektit;
- Përshkrim i ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë në zonën e projektit.

4.2. Përshkrim i biodiversitetit në zonën e projektit

- *Përshkrimi i habitateve kryesore në zonën e projektit si dhe harta ilustruese*
- *Përshkrimi i vegjetacionit në secilin habitat dhe statusit të ruajtjes kombëtar dhe ndërkombëtar të tyre;*
- *Përshkrimi i faunës në secilin habitat dhe statusit të ruajtjes kombëtar dhe ndërkombëtar të tyre;*
- *Përshkrimi i zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti përfshi edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj;*

4.3 Përshkrim i cilësisë së mjedisit dhe ndikimeve egzistuese

- *Cilësia e ujërave në zonën e studiuar për hartimin e raportit të thelluar të VNM-së;*
- *Cilësia e ajrit në zonën e studiuar për hartimin e raportit të thelluar të VNM-së;*
- *Niveli i zhurmave në zonën e studiuar për hartimin e raportit të thelluar të VNM-së;*
- *Administrimi i mbetjeve në zonën ku propozohet projekti;*
- *Probleme të tjera (nëse evidentohen) të tilla si erozioni i tokës, zjarret, ndotje historike etj;*
- *Presionet kryesore të mjedisit në zonën e projektit (të tilla si ndotjet e mjedisit, prerje pyjesh, etj)*

4.4 Përshkrim i karakteristikave sociale të zonës ku propozohet projekti:

- Njësia e qeverisjes vendore që administron zonën ku zbatohet projekti
- Popullsia dhe aktivitetet kryesore ekonomike të zonës
- Përdorimi i tokës në zonën e projektit
- Vlerat dhe objektet monumentale dhe arkeologjike në afërsi të zonës së projektit
- Administrimi i mbetjeve dhe ujërave të ndotura urbane

5. Një përshkrim të ndikimeve negative të rëndësishme të projektit të propozuar mbi mjedisin ku përfshihen:

5.1 Ndikimet negative në mjedis.

- *Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës së projektit;*
- *Ndikimet negative në habitate dhe biodiversitetin e zonës së projektit;*
- *Shkarkimet në mjedis dhe prodhimi i mbetjeve;*
- *Ndikimet negative shtesë (kumulative) në cilesinë e mjedisit në zonën e projektit dhe burimet natyrore si mineralet, pyje, burimet ujore;*
- *Ndikimet sociale të projektit të tilla si ndryshimi i përdorimit të tokës dhe shqetësimet që mund të lindin nga ndikimet në mjedis të projektit (si zhurmat, pluhuri, përdorimi i burimeve natyrore etj);*
- *Në varësi të natyrës të projektit një përshkrim i aksidenteve të mundshme me pasoja në mjedis;*

5.2 Karakteristikat e ndikimeve negative në mjedis;

- *Metoda e zbatuara për parashikimin e ndikimeve negative në mjedis*
- *Shtrirja fizike dhe kohëzgjatja e ndikimeve të identifikuar (shkalla);*
- *Lloji i ndikimeve të identifikuar (direkte dhe jo direkte);*
- *Mundësia e zbutjes së ndikimeve dhe argumentimet përkatëse nëse për ndikime të caktuara nuk mund të zbatohen/ndërmerren masa zbutese;*
- *Zonat e ndjeshme ndaj ndikimeve të projektit (zona të mbrojtura dhe habitate, qendra të banuara, burime ujore, zona arkeologjike etj);*

6. Ndikimet në mjedisin ndërkufitar të projektit (nëse ka të tilla)

7. Ndikimet pozitive në mjedisin e zonës të projektit

8. Masat e propozuara për mbrojtjen e mjedisit nga secili ndikim negativ i identifikuar në paragrafin 5 mësipër;

9. Programin e monitorimit të ndikimeve në mjedis gjatë zbatimit të projektit;

10. Plani i Menaxhimit dhe Monitorimit të Mjedisit

- *Rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e secilës masë të propozuara për mbrojtjen e mjedisit në secilën fazë të projektit;*
- *Kostot përkatëse të zbatimit të masave të propozuara për mbrojtjen e mjedisit;*
- *Plani i komunikimit dhe informimit të publikut për ndikimet në mjedis, masat e marra për mbrojtjen e mjedisit dhe monitorimin e ndikimeve në mjedis gjatë zbatimit të projektit;*

11. Shtojcat e raportit të thelluar të VNM

- *Përmbledhje në gjuhë jo teknike të raportit të thelluar të VNM-së;*
- *Kërkesat e vecanta të AKM-së dhe institucioneve të konsultuara sipas seksionit "C" dhe "D" të këtij vendimi;*



- *Informacion për mënyrën e realizimit të konsultimit gjatë procesit të hartimit të raportit të thelluar VNM-së dhe metodat e konsultimit, rezultatet përkatëse, kontaktet e personave dhe subjekteve që kanë marrë pjesë në këtë proces, mendimet që janë dhënë dhe arsyetimet sesi janë adresuar ose jo në raportin e thelluar të VNM-së përfshi edhe kërkesat e mendimet e dhëna në degjësën publike;*
- *Listat e llojeve floristike dhe faunistike në zonën e projektit dhe statusi i ruajtjes/mbrojtjes kombëtar dhe ndërkombëtar;*
- *Referencat e burimeve të informacionit të përdorur në raportin e thelluar të VNM-së;*
- *Certifikaten dhe licensen peraktese te QKL-se, te specialistit qe ka hartuar raportin paraprak te VNM-se*

SHTOJCA III – Kriteret ndihmëse për shqyrtimin e raportit të thelluar të VNM-së dhe hartimin e Deklaratës Mjedisore:

- a. mënyrën sesi është zbatuar procedura e VNM-së;
- b. mënyrën se si është zbatuar procedurës së informimit, konsultimit dhe degjësës publike;
- c. mënyrën sesi janë marrë në konsideratë në raportin e thelluar të VNM-së, mendimet dhe sugjerimet e dhëna nga palët e përfshira gjatë procedurës së VNM-së sidomos ato të konsultimit e degjësës publike;
- d. paraqitja e informacionit në raportin e thelluar të VNM-së në përputhje me strukturën e Shtojcës II;
- e. ndikimet e mundshme negative në zonat e mbrojtura;
- f. llojet e ndikimeve negative të rëndësishme në mjedis, sasia, kohëzgjatje dhe shtrirja hapësinore e secilit prej tyre;
- g. mundësia e zbatimit dhe efektshmëria e pritshme të masave zbutëse të propozuara për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të projektit;
- h. saktësia e të dhënave dhe informacionit të paraqitur në raportin e thelluar të VNM-së dhe verifikueshmëria e burimeve të të dhënave të përdorura;
- i. përputhjen e projektit të propozuar me objektivat e mbrojtjes së mjedisit, dhe normat e standartet mjedisore në fuqi;
- j. përputhjen e projektit me planet egzistuese të përdorimit të tokës dhe zhvillimit ekonomik në nivel lokal, rajonale dhe kombëtar;
- k. konsiderimin e alternativave dhe analizës përkatëse për zbatimin e projektit të propozuar;
- l. në rast të VNM, ndër-kufitare, mënyrën sesi është zbatuar procedura përkatëse;

UDHËZIM
Nr. 3, datë 22.1.2013

**PËR DISA SHITESA NË UDHËZIMIN NR. 26, DATË 4.9.2008 “PËR TAKSAT KOMBËTARE”,
TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Në pikën 2.4.6 bëhet ndryshimi me këtë përmbajtje:

2.4.6 Pjesa e të ardhurave nga renta minerare, që u takon njësitë të qeverisjes vendore (përfshirë edhe ato të naftës sipas pikës 2.4.5), shpërndahet nga strukturat përgjegjëse të buxhetit në Ministrinë e Financave, sipas kriterëve ligjore të përcaktuara në aneksin nr. 1 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”. Sipas këtij aneksi, njësitë e qeverisjes vendore përfitojnë +50 për qind rentë minerare mbi transfertën e pakushtëzuar, pasi transfertat dhe renta të jenë të barazuar.

Në pikën 2.4.7 bëhet ndryshimi me këtë përmbajtje:

2.4.7 Ministria e Financave njofton zyrtarisht Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, degën doganore respektive dhe njësinë e qeverisjes vendore, për masën e llogaritur të shpërndarjes së të ardhurave nga renta, sipas pikës 2.4.6 të këtij udhëzimi. Drejtoritë rajonale të tatimeve dhe doganave paraqesin kërkesën për transferimin e fondit në degën përkatëse të thesarit. Dega e thesarit ku ndodhet drejtoria rajonale tatimore e tatimpaguesit procedon, duke përdorur metodën e transferimeve të brendshme në sistemin e informatizuar financiar të qeverisë.

Për shembull: njësia vendore “X” sipas tabelës 3 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, përfiton 10 000 mijë lekë transfertë të pakushtëzuar për vitin 2013. Struktura përgjegjëse në Ministrinë e Financave për disbursimin e rentës për njësitë vendore, kryen përlllogaritjet e mëposhtme:

a) Nëse sipas informacioneve që vijnë në Ministrinë e Financave nga drejtoritë rajonale të tatimeve dhe të doganave, rezultojnë që njësia “X” përfiton 9 000 mijë lekë rentë minerare, atëherë meqenëse renta minerare është më e vogël sesa transfertat e pakushtëzuar ($9\,000 < 10\,000$), kjo njësi nuk përfiton pjesë nga renta minerare.

b) Nëse sipas informacioneve që vijnë në Ministrinë e Financave nga drejtoritë rajonale të tatimeve dhe të doganave rezultojnë se njësia “X” përfiton 10 000 mijë lekë rentë minerare, atëherë meqenëse renta minerare është e barabartë me transfertën e pakushtëzuar ($10\,000 = 10\,000$), kjo njësi nuk përfiton pjesë nga renta minerare.

c) Nëse sipas informacioneve që vijnë në Ministrinë e Financave nga drejtoritë rajonale të tatimeve dhe të doganave, rezultojnë që njësia “X” përfiton 15 000 mijë lekë rentë minerare, atëherë sipas aneksit nr. 1 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, njësisë “X” i takon t’i disbursohen deri në +50 për qind rentë minerare mbi transfertën e pakushtëzuar, pasi transfertat dhe renta janë barazuar. Pra $0.5 \times 10\,000 \text{ mijë lekë} = 5\,000 \text{ mijë lekë}$ sipas kushtit që renta është 15 000 mijë lekë ($15\,000 - 10\,000 = 5\,000 = +50$ për qind).

Në këtë rast, struktura përgjegjëse në Ministrinë e Financave njofton drejtoritë rajonale të tatimeve dhe të doganave dhe njëkohësisht njësinë vendore “X” për masën e shpërndarjes së rentës minerare për shumën 5 000 mijë lekë në favor të kësaj njësie.

ç) Në rast se njësia vendore “X” sipas informacioneve të drejtorive rajonale të tatimeve dhe doganave, përfiton 11 000 mijë lekë rentë minerare, atëherë asaj (njësisë “X”) i transferohen 1 000 mijë lekë (meqenëse kushti është deri në +50 për qind mbi transfertën e pakushtëzuar, pasi renta dhe transfertat të jenë barazuar).



Në këtë rast, struktura përgjegjëse në Ministrinë e Financave njofton drejtoritë rajonale të tatimeve dhe doganave dhe njëkohësisht njësinë vendore “X” për masën e shpërndarjes së rentës minerare për shumën 1 000 mijë lekë në favor të kësaj njësie.

d) Nëse sipas informacioneve që vijnë në Ministrinë e Financave nga drejtoritë rajonale të tatimeve dhe të doganave rezulton që njësia “X” përfiton 20 000 mijë lekë rentë minerare, atëherë kësaj njësie duhet t’i transferohen vetëm 5 000 mijë lekë, sepse kjo përfiton +50 për qind mbi transfertën e pakushtëzuar, pasi kjo të jetë barazuar me rentën. Shuma 20 000 mijë lekë plotëson kushtin e parë që është mbi nivelin e transfertës për 10 000 lekë dhe së dyti transferohen vetëm +50 për qind mbi transfertën, që në rastin tonë është 5 000 mijë lekë.

Në këtë rast, struktura përgjegjëse në Ministrinë e Financave njofton drejtoritë rajonale të tatimeve dhe të doganave dhe njëkohësisht njësinë vendore “X” për masën e shpërndarjes së rentës minerare për shumën 5 000 mijë lekë në favor të kësaj njësie.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr. 4, datë 22.1.2013

PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 13.5.2008 “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHITUAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shitur”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 “Për TVSH-në”, të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Pika 8.7 “Operacionet hidrokarbure”, ndryshon si më poshtë:

I) Në paragrafin e parë pas shprehjes “zhvillimit të operacioneve hidrokarbure” shtohet paragrafi:

Kontraktori ose nënkontraktori paraqet pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore në të cilën është i regjistruar:

1. Vërtetimin (original) ose kopje të noterizuar, të lëshuar në emër të tij nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), ku të përcaktohet se shërbimi që do të furnizohet është i lidhur me realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure.

2. Kopje të marrëveshjes së hidrokarbureve të lidhur ndërmjet kontraktorit dhe qeverisë shqiptare.

3. Kopje të kontratës së lidhur midis kontraktorit të operacioneve hidrokarbure dhe nënkontraktorit të tij në rastin kur furnizimi që do të kryhet realizohet nga nënkontraktori.

II. Paragrafi me përmbajtjen e mëposhtme shfuqizohet:

“Në rastin e importimit të nënprodukteve të naftës, për nevojat e veta, nga subjektet e kërkimit të naftës dhe të vënies në shfrytëzim të zonave naftëmbajtëse, përjashtimi nga TVSH-ja jepet për produktet dhe sasi të përcaktuara në autorizimet e përjashtimit të akcizës, të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në bazë të udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, udhëzimit nr. 3, datë 4.5.2012 “Për përcaktimin dhe dokumentimin e sasive të nënprodukteve të naftës, të importura për nevojat e veta, nga shoqëritë e kërkimit të naftës dhe të vënies në shfrytëzim të zonave naftëmbajtëse”.

3. Në pikën 19.5 “Raste të veçanta për trajtimin e së drejtës për kreditimin e TVSH-së”, bëhen këto shtesa:

Në sesionin I “Ndërtim” pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:
“dh) prodhim tullash dhe tjegullash 33 %”

Në sesionin II “Transport” pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:
“c) Transport mallrash me mjete teknologjike 78 %”.

4. Pas pikës 20.3, shtohet pika 20.4, me këtë përmbajtje:

20.4 Në zbatim të nenit 26 të ligjit nr. 9840, datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të instrumentit të parazgjerimit (IPA)” kontratorët (organizatat jofitimprurëse) e projekteve të financuara nga IPA rimburohen nga Drejtoria Rajonale Tatimore për TVSH-në e paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve në kuadër të të tilla projekteve, pas dorëzimit të kërkesës për rimbursim TVSH dhe dokumenteve të tjera të nevojshme sipas këtij udhëzimi.

Me lidhjen e kontratës me delegacionin e KE-së në Tiranë, OJF-të duhet të bëjnë një kërkesë pranë drejtorisë rajonale tatimore ku janë të regjistruar si OJF, për regjistrim për efekt rimbursimi TVSH-je në kuadër të zbatimit të projektit IPA, duke i bashkëlidhur dokumentet e mëposhtme:

a) Një kopje të kontratës së noterizuar midis OJF-ve dhe delegacionit të KE-së në Tiranë, në gjuhën shqipe dhe angleze;

b) Emrin e projektit në gjuhën shqipe dhe angleze;

c) Shumën e grantit për projektin përkatës dhe periudha e kohëzgjatjes;

d) Emrin e organizatës jofitimprurëse përgjegjëse për projektin;

e) Dokumentacion që provon statusin jofitimprurës të organizatës.

Drejtoria Rajonale Tatimore regjistron në një regjistër të veçantë të tilla OJF për efekt të rimbursimit të TVSH-së së paguar në kuadër të këtyre projekteve dhe lëshon për OJF-të një certifikatë të regjistrimit të projektit për efekt të rimbursimit të TVSH-së. Një kopje e kësaj certifikate i përcillet delegacionit të KE-së në Tiranë.

Organizata jofitimprurëse i paraqet drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar, kërkesën për rimbursimin e TVSH-së së paguar për zbatimin e kësaj kontrate, duke i bashkëlidhur dokumentet e mëposhtme:

1. Certifikatën e regjistrimit për efekt të rimbursimit të TVSH-së;

2. Kopje të faturave origjinale të blerjeve të mallrave dhe shërbimeve në kuadër të zbatimit të projektit;

3. Vërtetimin e lëshuar nga Komisioni European së bashku me listën e konfirmuar të të gjitha faturave të detajuara për shpenzimet e kryera nga OJF-të në kuadër të projektit të financuar nga IPA.

Brenda 30 ditëve pas marrjes së kërkesës dhe verifikimit të shumës së pretenduar, drejtoria rajonale tatimore procedon me rimbursimin e TVSH-së.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode



URDHËR
Nr. 2, datë 14.1.2013

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, Sekretarit të Përgjithshëm z. Xhevdet Mehmetaj.
 2. Këto kompetenca do të ushtrohen deri në datën 31.12.2013.
 3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

URDHËR
Nr. 13, datë 15.1.2013

**PËR MIRATIMIN E PËRMBAJTJES DHE FORMËS SË “KONTRATËS TIP” PËR DHËNIEN
ME QIRA TË TOKAVE BUJQËSORE, TË PANDARA**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe kreut V pika 1 e udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”,

URDHËROJ:

1. Përmbajtja dhe forma e kontratës tip për dhënie me qira të tokave të pandara, të jetë sipas lidhjes nr. 1, bashkëngjitur këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli

KONTRATË TIP
PËR DHËNIEN ME QIRA TË TOKËS BUJQËSORE, TË PANDARË

Sot, në _____, më datë ____ . ____ . _____, hartohet kjo kontratë ndërmjet:

Komunës/bashkisë/Drejtoria Rajonale e Bujqësisë (DRB) _____ përfaqësuar nga _____ (në vazhdim do të quhet “qiradhënësi”) dhe

Z. _____, lindur në _____, më datë _____, banues në _____ në adresën: _____, dokument identifikimi me nr: _____ (në vazhdim do të quhet “qiramarrësi”).

Ose në rast kur qiramarrësi është person juridik:

Shoqëria _____, një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar me numër identifikimi të subjektit NUIS: _____, me seli në

adresën _____, përfaqësuar nga Z. _____ në cilësinë e _____, me dokument identifikimi nr. _____ (në vazhdim “qiramarrësi”).

Pjesëmarrësit në këtë kontratë do të quhen individualisht “pala” dhe bashkërisht “palët”,
HYRJE

A. Qiradhënësi është pronar/përdorues i pasurisë së paluajtshme të kategorisë tokë bujqësore me sipërfaqe prej _____ ha, me nr. pasurie: _____, nr. kadastral: _____, e ndodhur në _____ (në vazhdim “pasuria”);

B. Pasuria është objekt i legjislacionit në fuqi për qiranë e tokave bujqësore të pandara, dhe më konkretisht, i ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ligjit nr. 8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 21.8.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, të ndryshuar, i udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara”, i udhëzimit të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nr. 10, datë 13.9.2012 “Për mënyrën e përlllogaritjes së kriterëve të vlerësimit të ofertave për marrje me qira të tokës bujqësore, të pandarë”, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, që kanë si objekt tokën bujqësore (në vazhdim “Legjislacioni në fuqi për tokat bujqësore”);

C. Qiramarrësi sipas vendimit nr. _____, datë _____, të autoritetit qiradhënësi rezulton të jetë fitues i procedurës konkurruese të shpallur më datë _____, në lidhje me marrjen me qira të pasurisë.

Mbi sa më sipër, palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Objekti i kontratës

1. Objekt i kësaj kontrate është marrja me qira e pasurisë nga ana e qiramarrësit.
2. Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët dhe ka një afat ____ vjeçar.
3. Palët bien dakord që vlera e shpërblimit vjetor për marrjen me qira të pasurisë të jetë _____ lekë/ha, sipas ofertës fituese të procedurës konkurruese dhe të përcaktuar me vendim nga autoriteti qiradhënësi.
4. Vlera e shpërblimit vjetor për marrjen me qira të pasurisë është _____ lekë. Pagesa e qirasë për vitin e parë të qiramarrjes kryhet në momentin e lidhjes së kontratës, ndërsa për periudhën vijuese pas çdo 12 muajsh.
5. Pagesa kryhet në llogarinë bankare të komunës ose bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria sipas përcaktimeve të dhëna prej tyre.

Neni 2

Detyrimet e qiramarrësit

Qiramarrësi ka për detyrim që:

- a) Të shlyejë me kohë dhe në mënyrë korrekte çmimin e qirasë, të përcaktuar në nenin 1 më lart.
- b) Në rastin kur palë në këtë kontratë në cilësinë e qiradhënësit është DRB-ja, çmimi i pagesës vjetore të qirasë do t’i paguhet komunës/bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, sipas mënyrës së përcaktuar midis qiramarrësit, DRB-së dhe komunës ose bashkisë përfutuese të çmimit të qirasë. Qiramarrësi është i detyruar të dorëzojë pranë DRB-së kopje të dokumentit bankar që vërteton pagesën e çmimit të qirasë për llogari të komunës/bashkisë.
- c) Të përdorë pasurinë sipas kriterëve të mëposhtme:
 - i) toka do të përdoret vetëm për veprimtari bujqësore dhe blegtorale;
 - ii) do të ruajë funksionet natyrore që përmbush toka bujqësore si kategori resursi;
 - iii) do të zbatojë një praktikë të mirë bujqësore, të përcaktuar në nenin 16 të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”;



iv) toka do të shfrytëzohet mbi të drejtën e përcaktuar në nenin 17 të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”;

v) do të sigurojë të gjithë bazën materiale dhe infrastrukturën për kryerjen e veprimtarisë bujqësore e blegtorale mbi tokën bujqësore në përputhje me të gjitha elementet dhe kriteret e përmbajtura në kërkesën e paraqitur nga qiramarrësi pranë autoritetit qiradhënës për marrjen me qira të pasurisë;

vi) mosdhënien me nënqira të tokës bujqësore, pa marrë pëlqimin me shkrim të qiradhënësit.

ç) Në sipërfaqen e pasurisë të realizojë mbjelljen e kulturave bujqësore, të paraqitura në kërkesën për qiramarrje, sipas këtij kalendar:

- Kultura _____, deri në fund të vitit _____ mbillen _____ ha;

- Kultura _____, deri në fund të vitit _____ mbillen _____ ha;

(.....dhe bimë të tjera që parashikohet të kultivohen sipas kërkesës të paraqitur për qiramarrjen).

d) Të mos pengojë qiradhënësin ose persona të autorizuar të tij që në çdo kohë të ushtrojnë kontroll në lidhje me pasurinë për të përcaktuar nëse qiramarrësi respekton detyrimet dhe kushtet ligjore të legjislacionit mbi tokën bujqësore, ato të kësaj kontrate, si dhe kriteret dhe elementet e përcaktuara në kërkesën e paraqitur prej tij pranë autoritetit qiradhënës për marrjen me qira të pasurisë.

dh) Të depozitojë dhe të regjistrojë këtë kontratë pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

e) Të përballojë shpenzimet e lidhura me regjistrimin sipas germës “dh” të këtij neni, si dhe shpenzimet e tjera në lidhje me këtë kontratë.

Neni 3

Detyrimet e qiradhënësit

Qiradhënësi ka për detyrë që:

a) t’i dorëzojë qiramarrësit pasurinë, objekt i kësaj kontrate. Kontratës i bashkëngjitet planimetria përkatëse e pasurisë;

b) të mos kërkojë nga qiramarrësi pagimin e taksës vendore mbi tokën bujqësore, për të gjithë kohën që kontrata është në fuqi;

c) të ushtrojë kontrole periodike mbi pasurinë, për të verifikuar nëse qiramarrësi respekton detyrimet dhe kushtet ligjore të legjislacionit mbi tokën bujqësore, ato të kësaj kontrate, si dhe kriteret dhe elementet e përcaktuara në kërkesën e paraqitur prej tij pranë autoritetit qiradhënës për marrjen me qira të pasurisë;

ç) në çdo rast, kur konstaton se qiramarrësi e ka dhënë tokën me nënqira pa pëlqimin e tij, ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës.

Neni 4

Detyrat e përbashkëta të të dyja palëve

1. Kur kontrata ka një afat mbi 10 vjet, atëherë palët mund t’i kërkojnë njëra-tjetrës rinegocimin e çmimit për ha të qirasë vjetore të pasurisë në përshtatje me dispozitat e legjislacionit që rregullojnë qiradhënien e tokave bujqësore të pandara, të kohës kur bëhet negociimi. Në rast se sipas legjislacionit për qiranë e tokave bujqësore të pandara të kohës së negociimit, çmimi minimal për ha i qirasë vjetore, të përcaktuar sipas këtij legjislacioni, është më i madh se sa çmimi për ha i qirasë vjetore, të përcaktuar në kontratë atëherë, së paku çmimi i qirasë i rinegociuar duhet ta kalojë vlerën çmimin minimal.

2. Pretendimet e njërës palë, për ndryshim të kushteve të kontratës, i paraqiten palës tjetër 180 ditë para se të kërkohej zbatimi i veprimit të kërkuar.

3. Kalimi i pjesshëm ose i plotë i tokës bujqësore të dhënë me qira në tokë urbane, sipas miratimit të organeve kompetente për planifikimin e territorit, bëhet sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Neni 5
Zgjidhja e kontratës

1. Kjo kontratë përfundon në momentin e përfundimit të afatit të saj të përcaktuar në nenin 1.
2. Në rastin kur qiramarrësi nuk ka zbatuar detyrimet e kësaj kontrate, të përcaktuara në nenin 2 pika “a” dhe “b”, atëherë qiradhënësi i kërkon me shkrim qiramarrësit përmbushjen e këtij detyrimi brenda 3 muajve nga data e marrjes së njoftimit. Në rast se qiramarrësi nuk e përmbush detyrimin brenda këtij afati, atëherë qiradhënësi njofton qiramarrësin për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës.
3. Në rastin kur qiramarrësi nuk ka zbatuar detyrimet e kësaj kontrate të përcaktuara në nenin 2 pika “c”, atëherë qiradhënësi i njofton qiramarrësit zgjidhjen e menjëhershme të kontratës.
4. Në rastin kur qiramarrësi nuk ka zbatuar detyrimet e kësaj kontrate të përcaktuar në nenin 2 pika “ç”, atëherë:
 - a) kur nuk respekton afatin e mbjelljes së kulturave të përcaktuara në pikën “ç”, atëherë qiradhënësi i kërkon me shkrim qiramarrësit përmbushjen e këtij detyrimi brenda vitit bujqësor pasardhës. Në rast të mospërmbushjes së këtij detyrimi brenda afatit të njoftuar nga qiradhënësi, atëherë ky i fundit e njofton me shkrim qiramarrësin për zgjidhjen e kontratës pas një afati prej 6 muajsh nga marrja e njoftimit;
 - b) kur nuk respekton mbjelljen e llojit të kulturave të përcaktuara në kërkesën për qiramarrje, si dhe sipërfaqen përkatëse të përcaktuar në këtë kërkesë, atëherë qiradhënësi e njofton me shkrim qiramarrësin për zgjidhjen e kontratës pas një afati prej 6 muajsh nga marrja e njoftimit.
5. Në rastin e zgjidhjes së parakohshme të kontratës sipas përcaktimeve të pikave 2-4 të këtij neni, qiramarrësi nuk do të kërkojë asnjë kompensim të investimeve të trupëzuara në tokën bujqësore, si p.sh.: kulturat bujqësore shumëvjeçare, si dhe vepra kulluese e ujitëse.

Neni 6
Sanksione

1. Qiradhënësi paguan gjobë 1% të çmimit të qiradhënies për çdo ditë vonesë në dorëzimin e tokës, duke filluar nga data e përcaktuar në procesverbal për dorëzimin e tokës dhe të shënuar në këtë kontratë.
2. Qiramarrësi paguan gjobë 1% të detyrimit për çdo ditë vonesë në pagesën e qirasë, duke filluar nga data e përcaktuar në këtë kontratë.

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Ndërmjet palëve, çdo mosmarrëveshje lidhur me zbatimin e detyrimeve ose interpretimin e kushteve të kësaj kontrate, në rast se nuk zgjidhet me mirëkuptim, çështja i paraqitet për gjykim gjykatës së rrethit në juridiksion të të cilit ndodhet toka bujqësore.
 2. Palët kontraktuese e hartojnë dhe e lidhin këtë kontratë në përputhje me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr. 8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 21.8.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.
- Kjo kontratë hartohet në 4 kopje me vlerë të barabartë.

PËR PALËT KONTRATUESE
Qiradhënësi

Qiramarrësi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 30.1.2013
Doli nga shtypi më 31.1.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 24 lekë